



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2082 Prot.

Tiranë, më 21/07/2025

V E N D I M

(QARKULLUES)

Nr. 48, datë 18.07.2025

P Ë R

**NJË SHITESË TË VENDIMIT NR. 02, DATË 10.02.2025 “PËR MIRATIMIN E
KRITEREVE TË PRANIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE
DHE PROGRAMET E INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, PËR
VITIN AKADEMIK 2025 – 2026, I PËRDITËSUAR”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 25 dhe neni 74, Statutin e Universitetit Politeknik, neni 9, si dhe në propozimet e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike dhe Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, për kriteret e pranimi në programet e reja të ciklit të parë të studimeve, për vitin akademik 2025-2026, Senati Akademik me vendim qarkullues të datës 18.07.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret e pranimi, për vitin akademik 2025-2026, në programet e reja të ciklit të parë të studimit:
 - a. Bachelor në Inxhinieri Matematike dhe Data Science;
 - b. Diplomë e dyfishtë: Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike;
 - c. Diplomë e dyfishtë: Bachelor në Inxhinieri të Sistemeve Elektronike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Kurrikulave për të shpallur publikisht kriteret e pranimi në faqen zyrtare të UPT dhe në portalin U-Albania.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS SENATI AKADEMIK

Kriteret e pranimit në programet e reja të ciklit të parë të studimit në UPT, për vitin akademik 2025 – 2026.

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 25 dhe neni 74, Statutin e Universitetit Politeknik neni 9, si dhe në propozimet e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike për pranimet në programet e reja të ciklit të parë të studimit, kriteret e pranimit të ofruara nga këto fakultete të UPT-së për vitin akademik 2025-2026, janë si më poshtë:

1. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, me programet e studimit:

1. Bachelor në Inxhinieri Matematike në Data Science

ka vendosur këto kriteret:

- Nota mesatare minimale në hyrje, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”, neni 74, pika 1, do të jetë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, i ndryshuar.
- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:

$$[0.7 * \text{Mes}(\text{VKM}) + 0.3(0.5 * \text{Mes}(\text{Matematike}) + 0.4 * \text{Mes}(\text{Fizike}) + 0.1 * \text{Mes}(\text{Kimi}))] * K_{\text{koef. Shkollës}} * 1000$$

Ku:

Mes(vkm), nota mesatare e thjeshtë, e të gjitha viteve të shkollës së mesme, e llogaritur sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020, i ndryshuar pika 5;

Mes(Matematike), nota mesatare e thjeshtë e matematikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin në provimet e Maturës Shtetërore;

Mes(Fizike), nota mesatare e thjeshtë e fizikës, në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin e kësaj lënde në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore;

Mes(Kimi), nota mesatare e thjeshtë e kimisë në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin e kësaj lënde në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore;

K_{koef. Shkollës}, koeficienti i shkollës së mesme, sipas tabelës së koeficienteve për vitin akademik 2025 – 2026.

Kandidatët fitues do të përcaktohen nga renditja e tyre sipas kriterit të mësipërm dhe kuotat e pranimit të përcaktuara për çdo program studimi.



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

2. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit me programet e studimit:

1. Diplomë e dyfishtë “Bachelor në Inxhinieri e Sistemeve Elektronike”
2. Diplomë e dyfishtë “Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike”

ka vendosur këto kritere:

- Nota mesatare minimale në hyrje, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”, neni 74, pika 1, do të jetë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, i ndryshuar.
- Rënditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:

$$[0.7 * \text{Mes}_{VKM} + 0.3(0.6 * \text{Mes}_{\text{Matematike}} + 0.4 * \text{Mes}_{\text{Fizike}})] * K_{\text{koef. Shkollës}} * 1000$$

Ku:

Mes_(VKM), nota mesatare e thjeshtë, e të gjitha viteve të shkollës së mesme, e llogaritur sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020, i ndryshuar pika 5;

Mes_(Matematike), nota mesatare e thjeshtë e matematikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin në provimet e Maturës Shtetërore;

Mes_(Fizike), nota mesatare e thjeshtë e fizikës, në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin e kësaj lënde në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore;

K_{koef. Shkollës}, koeficienti i shkollës së mesme, sipas tabelës së koeficienteve për vitin akademik 2025 – 2026.

Kandidatët fitues do të përcaktohen nga renditja e tyre sipas kriterit të mësipërm dhe kuotat e pranimit të përcaktuara për çdo program studimi.

